



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:034639

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06181299

KPPP.nr. 553/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit K.R.U “Drini i Bardhë”, me seli në Pejë, rr. “Mbretëresha Teutë”, kundër debitorit N.T.P “Ermal Trofta”, me seli në Istog, rr. “Hysen Bujupaj”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 128/22, i lejuar me datë 27.10.2022, nga Përmbartuesi Privat Shpend Ahmetaj me seli në Pejë, jashtë seancës me datë 19.09.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET pjesërisht prapësimi i debitorit N.T.P “Ermal Trofta” me seli në Istog, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr. 128/22, i lejuar me datë 27.10.2022 nga Përmbartuesi Privat Shpend Ahmetaj, për borxhin në shumë prej 200.00 EUR, dhe në këtë pjesë të përmbartimit procedura PËRFUNDOHET.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit N.T.P “Ermal Trofta” me seli në Istog, ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr. 128/22, i lejuar me datë 27.10.2022 nga Përmbartuesi Privat Shpend Ahmetaj, sa i përket borxhit në shumë prej 1,155.00 EUR.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit K.R.U “Drini i Bardhë”, mbi bazën e dokumenteve: Faturës nr. 461/18 e datës 30.11.2018; Faturës nr. 486/18 e datës 27.12.2018; Faturës nr. 20/21 e datës 24.02.2021; Faturës nr. 21/21 e datës 24.02.2021; Faturës nr. 22/21 e datës 02.03.2021; Faturës nr. 70/21 e datës 05.04.2021; Faturës nr. 114/21 e datës 05.07.2021; Faturës nr. 137/21 e datës 04.06.2021; Faturës nr. 162/21 e datës 05.07.2021; Faturës nr. 359/21 e datës 05.08.2021; Faturës nr. 510/21 e datës 05.09.2021; Faturës nr. 685/21,

e datës 05.10.2021; Faturës nr. 729/21 e datës 05.11.2021 dhe Faturës nr. 751/21 e datës 03.12.2021, ka lëshuar Urdhri Përmbartimor P.nr. 128/22 me datë 27.10.2022, me të cilin është urdhëruar debitori N.T.P “Ermal Trofta” me seli në Istog, që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimi të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 1,355.00 (njëmijë e treqind e pesëdhjetë e pesë euro), si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor e ka kundërshtuar urdhri përmbartimor me arsyetim se borxhi i kërkuar me propozimin për përmbartim është i parashkuar për periudhën nga viti 2018 deri në vitin 2021, konform nenit 360, par. 1 dhe 1.1 të LMD-së. Më tej, ka theksuar se dokumentet në bazë të cilave është lejuar urdhri përmbartimor nuk janë të përshtatshme për përmbartim pasi që nuk përmbajnë afatin e përmbushjes së detyrimit, si dhe nuk janë në origjinal dhe as kopje të vërtetuar. I ka propozuar gjykatës që të pranojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigjen në prapësim ka theksuar se pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim nuk përmbajnë asnjë nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet prapësimi sipas nenit 71 të LPP-së. Ka shtuar se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të faturave si dokument i besueshëm, të cilat i janë dorëzuar debitorit dhe janë të nënshkuara dhe vulosura nga i njëjti. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke ju referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*

Gjykata, duke vlerësuar pretendimet e debitorit për parashkrim të borxhit që kërkohet nga kreditori në këtë procedurë përmbarimore, pas shqyrtimit të faturave mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri përmbarimor ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar . Deri tek ky vlerësim gjykata erdhi duke iu referuar nenit 355.1 të LMD-së, i cili parasheh se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të po të njëjtit nen është përcaktuar se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në rastin konkret, duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për Faturën nr. 461/18 të datës 30.11.2018 dhe Faturës nr. 486/18 të datës 27.12.2018 në shumën prej EUR 200.00 kanë arritur afatin e parashkrimit nga neni 355 i LMD-së, ngase propozimi për përmbarim nga ana e kreditorit në raport me këto fatura është paraqitur me datë 27.10.2022, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e arritjes për pagesë.

Andaj, në mbështetje të nenit 71 par. 1.10 të LPP-së me të cilin përcaktohet se prapësimi mund të bazohet vetëm nëse *“kërkesa nga dokumenti përmbarues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve”* gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke anuluar urdhrin përmbarimor P.nr. 128/22 të datës 27.10.2022 për shumën prej 200.00 EUR.

Ndërsa, vendimin mbi përfundimin e procedurës përmbarimore në këtë pjesë të përmbarimit gjykata e mbështeti në nenin 12.2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”.*

Gjykata, vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke lënë në fuqi Urdhrin Përmbarimor P.nr. 128/22 të datës 27.10.2022 për shumën prej 1,155.00 EUR, pasi që faturat prej të cilave derivon ky borxh dhe atë fatura nr. 20/21 e datës 24.02.2021; fatura nr. 21/21 e datës 24.02.2021; fatura nr. 22/21 e datës 02.03.2021; fatura nr. 70/21 e datës 05.04.2021; fatura nr. 114/21 e datës 05.07.2021; fatura nr. 137/21 e datës 04.06.2021; fatura nr. 162/21 e datës 05.07.2021; fatura nr. 359/21 e datës 05.08.2021; fatura nr. 510/21 e datës 05.09.2021; fatura nr. 685/21 e datës 05.10.2021; fatura nr. 729/21 e datës 05.11.2021 dhe fatura nr. 751/21 e datës 03.12.2021, në shumën prej EUR 1,155.00, i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara me

nenin 29 par.3 të LPP-së, meqenëse në secilën faturë është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Tutje, faturat janë pranuar me rregull nga debitori, meqenëse në secilën faturë figuron nënshkrimi i palës debitore tek pranuesi.

Në anën tjetër, gjykata gjeti se faturat e lartcekura nuk janë përfshirë në parashkrim për arsye se për këtë pjesë të borxhit, propozimi për përmbarim është paraqitur brenda periudhës tre (3) vjeçare nga dita kur secila kërkesë është bërë e arritshme, e për të cilin borxh, debitori nuk ka ofruar asnjë provë siç kërkohet me nenin 69 par.4 të LPP-së për të dëshmuar se është përmbushur.

Nga sa më sipër, në mbështetje të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12.2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenit 13, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 553/24, datë 19.09.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.